



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/57

Datë: 13.03.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 56 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/57


Datë: 13.03.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12.2 të Ligjit Nr. 2003/14 mbi Planifikimin Hapësinor, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2009, mori

V E N D I M

1. Shpallet Zonë e Interesit të veçantë ekonomik “Fusha e Mihjes së Re” me një sipërfaqe prej 143,254 km², sipas hartës bashkangjitur këtij vendimi.
2. Zona e Interesit të Veçantë përfshinë disa nga zonat kadastrale të komunave: Kastriot, Fushë Kosovë, Vushtrri dhe Drenas, e të cilat preken nga këto veprimtari:
 - a) Mihjet ekzistuese të Korporatës Energjetike të Kosovës (Bardh, Mirash, Sirmicë);
 - b) Mihjen e Re (pjesa veriore e basenit të linjit “Kosova”);
 - c) Objektet ekzistuese të gjenerimit (TC Kosova A dhe TC Kosova B) me stabilimentet përcjellëse);
 - d) Palosjet e jashtme të djerrinës;
 - e) Deponitë e hirit (TC Kosova A dhe TC Kosova B);
 - f) Lokacionet e propozuara për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re; dhe
 - g) Zonën e paraparë me vendimin e Qeverisë Nr. 4/119 të datës 03 nëntor 2004.

3. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që të hartojë Planin Hapësinor për këtë zonë duke u bazuar në "Draft Planin Zhvillimor të fushës së Mihjes së Re" të përgatitur nga Projekti i Asistencës Teknike Energjia nga Linjiti i financuar nga Banka Botërore.
4. Vendimi Nr. 04/119 të datës 03 nëntor 2004 mbetet në fuqi deri në aprovimin e Planit Hapësinor për këtë zonë nga Kuvendi i Kosovës.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Kuvendit Komunal - Kastriot
- Kuvendit Komunal - Fushë Kosovë
- Kuvendit Komunal - Vushtrri
- Kuvendit Komunal - Drenas
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Energjisë dhe Minierave
Projekti i Asistencës Teknike Energjia nga Linjtë

Vlerësimi Strategjik Mjedisorë dhe Social
Zona e Interesit të veçantë ekonomik "Mihja e Re"

Projected Coordinate System:
KosovoRef, ETRF_1989_UTM_Zone_34N_Transverse_Mercator

Përfaqësim: 1:75,000




Sipërfaqja e zonës të interesit: ~ 143,254 km².

Legjenda

- Rruge
- Lum
- Proceke
- Kanali i Ibrit
- Kufiri i Milijës së Re
- KEK Licenca për shpërndarje
- TC Kosova A
- TC Kosova B
- TC KR pran TC B
- TC KR pran TC A
- TC KR pran Bivlakul
- Zona e ndikimit TC KR
- Deponi e hirit
- Palosje e dferimes
- Zonal kadastrale
- KufiriPFMR_Fin

Zona e interesit të veçantë ekonomik "Fusha Mihja e Re"



Arsyetimi i përkufizimit të zonës me interes të veçantë ekonomik

“Fusha e Mihjes së Re”

Shpallja e zonës me interes të veçantë ekonomik (“Fusha e Mihjes së Re”) dhe hartimi i planit hapësinor për këtë zonë bëhet me qëllim të identifikimit të ndryshimeve të strukturës hapësinore, shfrytëzimit të tokës dhe zhvendosjes së komunitetit në atë zonë, duke pasur parasysh investimet që do të bëhen në sektorin e energjisë dhe atë të minerave. Hartimi i Planit Hapësinor për zonën me interes të veçantë ekonomik bëhet duke u bazuar në Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor, respektivisht neni 12 i këtij ligji dhe po ashtu konform udhëzimit administrativ mbi “Elementet themelore të përmbajtjes së Planeve Hapësinore për zona të veçanta”.

Derisa termocentrali i ri “Kosova e Re” do të ndërtohet brenda një periudhe disa vjeçare, zhvillimi i fushës së mihjes së re do të jetë proces afatgjatë që do të ndodhë gjatë 4 – 5 dekadave të ardhshme. Paralelisht do të ndërmerren aktivitete të ndryshme e të shumta që ndryshojnë destinimin aktual të tokës dhe vetë peizazhin. Përveç aktiviteteve në prodhimin e energjisë dhe mihje, në dekadën e ardhshme do të rikultivohet edhe toka e shfrytëzuar për aktivitetet e mëparshme, duke ofruar kështu mundësi të reja për shfrytëzimin e asaj toke.

Shpallja e zonës si zonë e interesit të veçantë ekonomik dhe hartimi i planit hapësinor për këtë zonë, bëhet para së gjithash për të:

- përkufizuar implikimet hapësinore të zhvillimit të TC Kosova e Re dhe minierës së re;
- vendosur themelet dhe kornizën e planifikimit hapësinor për aktivitetet e Investuesit të sektorit privat, i cili do të ndërtojë TC Kosova e Re;
- propozuar masat e planifikimit hapësinor për trajtimin e pasojave në një mënyrë të pranueshme në aspektin mjedisor dhe shoqëror, si dhe
- ofruar udhëzime për komunitatet e prekura në planifikimin e tyre hapësinor lokal.

Zona e identifikuar si zonë me interes të veçantë ekonomik gjendet në pjesën veriore të basenit të linjtit të Kosovës. Përkufizimi i kufirit të zonës është bazuar në kufijtë administrativ kadastral (zonave kadastrale të vendbanimeve) të cilat preken nga zhvillimet aktuale dhe ato të planifikuara në të ardhmen.

Zona në tërësi ka një sipërfaqe prej 143,253 km² dhe përfshinë gjithsej 22 zona kadastrale të vendbanimeve të shtrira në komunat: Kastriot/Obiliq, Fushë Kosovë, Vushtrri dhe Drenas. Zona e interesit është e kufizuar me *malet e Çiçavicës* si dhe me *lumin Drenica* në Perëndim si dhe me *Lumin Sitnica* në me rrafshinën e ujitjes në lindje. Kufiri jugor është i shënuar nga tokat e shfrytëzuara të minierave sipërfaqësore të Mirashit dhe Bardhit si dhe deponitë e jashtme të zgjeruara të djerrinës, ndërsa në veri të mihjeve ekzistuese të linjitet shtrihet toka bujqësore.

Plani në fjalë do të përfshinë një vlerësim të aktiviteteve të planifikuara dhe ndikimin e tyre në ambient dhe vlerësimin e hollësishëm të ndikimit pozitiv ekonomik të mundshëm të aktiviteteve të tilla të planifikuara.

Plani duhet të përbëhet nga teksti, hartat dhe grafikët të cilët paraqesin gjendjen aktuale, pasojat hapësinore dhe ndryshimet si dhe ndryshimet e shkaktuara nga prodhimi i energjisë elektrike dhe aktivitete minerare nga TC Kosova e Re dhe ndahet në 5 pjesë:

- i. Profili hapësinor të zonës së interesit të Planit Zhvillimor (“Fusha e Mihjes së Re”) dhe përshkruan gjendjen ekzistuese;
- ii. Vizionin e sugjeruar, parimet dhe synimet e Planit Zhvillimor (“Fusha e Mihjes së Re”);
- iii. Planin e propozuar për zhvillim hapësinor të zonës së planifikuar;
- iv. Strategjinë e sugjeruar dhe aktivitetet për implementimin e Planit Zhvillimor (“Fusha e Mihjes së Re”), dhe
- v. Udhëzimet për implementimin e Planit Zhvillimor (“Fusha e Mihjes së Re”).



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Energjitik dhe Minsierave
Projekt i Asistencës Teknike Energjia nga Lirija

Vlerësimi Strategjik Mjedisorë dhe Social
Zona e Interesit të veçantë ekonomik "Mihja e Re"

Projekti Koordinatë Shtetë:
KosovoRef_ETRF_1686_UTM_Zona_347_Transverse_Mercator


Shkallë: 1:75.000
0 500 1.000 2.000 3.000
Metra

Sipërfaqja e zonës të interesit: ~ 143,254 km²

Legjenda

- Rrugë
- Lum
- - - - - Proçke
- Kanali i Ibrit
- ***** Kufiri i Mihjes së Re
- ▨ KEK Licenca për shfrytëzim
- TC Kosova A
- TC Kosova B
- TC KR pran TC B
- TC KR pran TC A
- TC KR pran Bivokut
- ▨ Zona e ndikimit TC KR
- Deponi e hiri
- Patojë e djarrës
- Zonat kadastrale
- Kufiri HFMR_Fin

Zona e interesit të veçantë ekonomik "Fusha Mihja e Re"



Në vijim janë të listuar zonat kadastrale të vendbanimeve dhe arsyeja e përfshirjes së tyre Brenda kufirit të Zonës me interes të veçantë ekonomik për Republikën e Kosovës.

1. K. Obiliq- zona kadastrale **Dardhishtë**
Deponia e hirit të TC Kosova A, miniera e Sitnicës, ndikimi nga TC Kosova A
2. K. Obiliq- zona kadastrale **Obiliq**
Ndikimi nga TC Kosova A dhe TC Kosova B, deponia e hirit në Dardhishtë
3. K. Obiliq- zona kadastrale **Palaj**
Miniera eksistuese e Mirashit, palosjet e djerrinës, ndikimi i TC Kosova A dhe B, zhvillimet e reja në Fushën e Mihjes së Re
4. K. Obiliq- zona kadastrale **Hade**
Minierat ekzistuese dhe zhvillimet e reja të planifikuara të Fushës së minierës së re
5. K. Obiliq- zona kadastrale **Shipitulle**
Palosjet e djerrinës dhe zhvillimet e reja të planifikuara të Fushës së minierës së re
6. K. Obiliq- zona kadastrale **Sibovc**
Zhvillimet e reja të planifikuara të Fushës së Mihjes së Re
7. K. Obiliq- zona kadastrale **Zhilivode**
Zhvillimet e reja të planifikuara të Fushës së Mihjes së Re
8. K. Obiliq- zona kadastrale **Lajthishtë**
Zhvillimet e reja të planifikuara të Fushës së Mihjes së Re dhe ndikimet nga të dy TC ekzistuese A dhe B
9. K. Obiliq- zona kadastrale **Plemetin**
Ndikimi nga TC Kosova B dhe deponia ekzistuese e hirit pranë termocentralit
10. K. Obiliq- zona kadastrale **Hamidi**
Zhvillimet e reja të planifikuara të Fushës së minierës së re dhe ndikimet nga të dy TC ekzistuese A dhe B
11. K. Obiliq- zona kadastrale **Millosheve**
Ndikime infrastrukturore, ndikimet nga TC KR në rast ndërtohet pran TC B
12. K. Obiliq- zona kadastrale **Mazgit**
TC Kosova A dhe ndikime infrastrukturore
13. K. Fushe Kosovë – zona kadastrale **Bardh i Madh**
Palosjet e djerrinës dhe miniera ekzistuese e Bardhit
14. K. Fushe Kosovë – zona kadastrale **Graboc i poshtëm**
palosjet e jashtme të djerrinës
15. K. Fushe Kosovë – zona kadastrale **F. Kosovë**
Ndikimi nga palosjet e jashtme të djerrinës dhe deponia e hirit pran Dardhishtës
16. K. Fushe Kosovë – zona kadastrale **Kuzmin**
Palosjet e jashtme të djerrinës
17. K. Fushe Kosovë – zona kadastrale **Pomazatin**
Palosjet e jashtme të djerrinës
18. K. Fushe Kosovë – zona kadastrale **Mirash**
Ndikimi nga mihjet ekzistuese, deponia urbane regionale dhe ndikimi nga aktivitete gjatë mbylljes dhe rikultivimit të palosjeve të djerrinës
19. K. Vushtrri – zona kadastrale **Bivolak**

Ndikimi i pjesërishëm nga aktivitete e mihjes dhe ndikimet eventuale në rast se Bivolaku zgjedhet si lokacion i përshtatshëm për ndërtimin e TC Kosova e Re

20. K. Vushtrri - zona kadastrale **Glavotine**

Ndikimet eventuale nga lokacion i propozuar për ndërtimin e TC Kosova e Re afër vendbanimit Bivolak

21. K. Vushtrri - zona kadastrale **Priluzhe**

Ndikimet eventuale nga lokacion i propozuar për ndërtimin e TC Kosova e Re afër vendbanimit Bivolak

22. K. Drenas – zona kadastrale **Vasiljeve**

Aktivitetet lidhur me rikultivimin e palosjeve të jashtme të djerrinës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/57

Datë: 13.03.2009


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12.2 dhe 16 të Ligjit Nr. 2003/14 mbi Planifikimin Hapësinor, të nenit 12 të Ligjit Nr. 03-L-106/2008 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 2003/14, nenit 23 të Ligjit Nr. 02/L-18/2005 për Mbrojtjen e Natyrës, nenit 25 paragrafi 2 i Ligjit për Parkun Nacional "Mali i Sharr" si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, me qëllim të hartimit të Planit Hapësinor për Parkun Nacional "Mali Sharr", Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2009, mori

V E N D I M

1. Të hartohet Plani Hapësinor për Zonën e Veçantë Parku Nacional "Mali Sharr".
2. Qëllimi i hartimit të Planit duhet të jetë shfrytëzimi i planifikuar i hapësirës; mbrojtja dhe përparimi i vlerave të trashëgimisë natyrore; zhvillimi i funksioneve shkencore-kërkimore dhe rekreative-turistike; përcaktimi i kaheve dhe zhvillimit në etapa të Parkut si dhe në bazë të planit të përcaktohen kushtet dhe rregullat për hapësirat e parapara për zhvillim.
3. Të gjitha aktivitetet dhe zhvillimet e paplanifikuara, deri në aprovimin e Planit Hapësinor për Zonën e Veçantë të Parkut Nacional "Mali Sharr" duhet të shqyrtohen.
4. Urdhërohen autoritetet komunale të komunave që përfshihen në kuadër të Parkut (Prizren, Shtërpçë, Kaçanik, Suharekë dhe Dragash) si dhe Drejtoria e Parkut, të veprojnë në bazë të këtij vendimi.

5. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për udhëheqjen e procesit dhe hartimin e Planit Hapësinor për Zonën e Veçantë Parku Nacional "Mali Sharr".

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/57


Datë: 13.03.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 25 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 02/L-18 dhe Rregullorja Nr. 2006/22), për Mbrojtjen e Natyrës si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2009, mori

V E N D I M

1. Vihet nën mbrojtje "Shpella e Gadimes" në Gadime të Ulët të komunës së Lypjanit, në rrëzë të kodrës "Murtur" në kategorinë e monumentit të natyrës me rëndësi të veçantë.
2. Monumenti i natyrës "Shpella e Gadimes" vihet nën mbrojtje si ndërlidhje unike e specifikave tektonike, gjeologjike, geomorfologjike dhe hidrologjike e formuar në mermer. Vlerë e veçantë e këtij monumenti të natyrës paraqet shfaqja e stolive aragonite.
3. Monumenti i natyrës "Shpella e Gadimes" shtrihet në territorin e komunës së Lipjanit, Komuna kadastrale Gadime e Ulët dhe përfshin sipërfaqen prej 38.64,95 ha. Në parcelat kadastrale në pronësi shtetërore, nr. 700, 699, 696, 694, 690, 689, 688, 686 dhe 682 me sipërfaqe prej 36.73,21 ha. dhe parcelat kadastrale në pronësi private nr. 697, 695, 693, 692, 691/1 në sipërfaqe prej 1.91,74 ha.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 01. nr. 1174-30 ("GZK" nr. 50/82).

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI
Kryeminister i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Kuvendit Komunal Lipjan
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 05/57

Datë: 13.03.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, si dhe vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/25, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2009, mori

V E N D I M

1. Lejohet Ministria e Punëve të Brendshme që të bëjë pagesën e 406 punëtorëve për muajin janar me nga 200 Euro, nga programi - shërbimet e regjistrimit me kod organizativ (148).
2. Të drejtën e përfitimit sipas pikës 1. të këtij vendimi e kanë 406 punëtorët e Departamentit të Prodhimit të Dokumenteve dhe Departamentit të Regjistrimit dhe Gjendjes Civile, të cilët kanë punuar jashtë orarit të punës, edhe të shtunave, për realizimin e programit "Pajisja e qytetarëve me dokumente të Republikës së Kosovës".
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Ministria e Shërbimeve Publike.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/57

Datë: 13.03.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2009, mori

V E N D I M

1. Themelohet komisioni qeveritar për çështje fiskale dhe buxhetore me qëllim që të ndihmohet zhvillimi i zbatimit të politikave fiskale, duke përfshirë zhvillimin vjetor të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.
2. Komisioni sipas pikës 1. të këtij vendimi do të ketë këtë përbërje:
 - a) Kryeministri i Republikës së Kosovës – kryesues
 - b) Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave;
 - c) Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
 - d) Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë;
 - e) Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - f) Ministri i Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit;
 - g) Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë
3. Komisioni i rekomandon Qeverisë lidhur me çështjet e politikave fiskale.
4. Stafi i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave do të shërbejë si sekretari e komisionit dhe do të aranzhojë takimet, përgatitjen e shkresave, letrave dhe materialeve tjera të nevojshme për mbarëvajtjen e punës së komisionit.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/57
Datë: 13.03.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2009, mori

V E N D I M

1. Në Strategjinë Legjislative të vitit 2009 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfshihet:
 - a) Projektligji për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Besueshmërisë.
2. Ngarkohet Zyra për Shërbime dhe Ndihmë Juridike në Zyrën Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/57
Datë: 13.03.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet, me vërejtje, Projektligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.
2. Udhëzohet grupi punues qeveritar për hartimin e projektligjit që t'i inkorporojë në tekstin e projektligjit vërejtjet e miratuara nga Qeveria.
3. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/57

Datë: 13.03.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2009, mori

V E N D I M


1. Themelohet Këshilli Ekonomiko-Social, për dialogim social i cili do të përbëhet nga përfaqësuesit e organizatave të punëmarrësve (sindikatave), organizatave të punëdhënësve dhe përfaqësuesve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Këshilli Ekonomiko-Social është organ i nivelit nacional, i cili udhëheqë konsultimet për çështjet nga marrëdhënia e punës, mirëqenia sociale dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me politikat ekonomike në Republikën e Kosovës.
3. Këshilli Ekonomiko-Social si organ më i lartë trepalësh është organ jopolitik dhe do të funksionojë si i pavarur, pa ndikim të ndonjë partie politike apo të ndonjë interesi politik që vjen nga jashtë.
4. Këshilli Ekonomiko-Social është përgjegjës për:
 - a) Këshillon institucionet e Republikës së Kosovës në krijimin dhe realizimin e politikave të punës, mirëqenies sociale dhe politikave ekonomike;
 - b) Nxitë kontratat dhe marrëveshjet kolektive, veçmas në nivel të Republikës së Kosovës;
 - c) Ndërmerr edhe aktivitetet e tjera të punës për zhvillimin dhe avancimin e politikave të punës dhe mirëqenies sociale për qytetarët.

5. Inicion propozime, zhvillon këshillime, merr vendime me konsensus dhe i bën rekomandime përkatëse Qeverisë, përmes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për çështjet për të cilat është përgjegjës, në pajtim me Marrëveshjen për themelimin e Këshillit Ekonomiko-Social.
6. Këshilli Ekonomiko-Social, përbëhet nga pesëmbëdhjetë (15) anëtarë;
 - a) Pesë (5) përfaqësues caktohen nga organizatat e punëmarrësve (sindikatat).
 - b) Pesë (5) përfaqësues nga organizatat e punëdhënësve,
 - c) Pesë (5) përfaqësues nga Qeveria, të përcaktuar me paragrafin 8 të këtij vendimi.
7. Përfaqësimi i organizatave të punëmarrësve dhe punëdhënësve në Këshillin Ekonomiko-Social, përcaktohet në përputhje me kushtet dhe kriteret e mëposhtme:
 - 7.1 Për organizatat e punëmarrësve (sindikatat):
 - a) Numrit të anëtarëve, i vërtetuar nga deklaratat personale dhe kuotizacionet e anëtarëve, i cili nuk mund të jetë më i vogël se 10% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në Republikën e Kosovës,
 - b) Numrit të kontratave kolektive të lidhura me ndërmarrjet apo institucionet e ndryshme,
 - c) Numrit të degëve sindikale,
 - d) Angazhimit për realizimin e marrëveshjeve kolektive dhe zgjidhjen e konflikteve përmes ndërmjetësimit dhe
 - e) Anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare të punëtorëve.
 - 7.2 Për organizatat e punëdhënësve:
 - a) Numrit të ndërmarrjeve të anëtarësuarra i cili nuk mund të jetë më i vogël se 10% i numrit të bizneseve të regjistruara;
 - b) Numrit të punëtorëve të punësuar në ndërmarrjet e anëtarësuarra ;
 - c) Angazhimit për realizimin e marrëveshjeve kolektive dhe zgjidhjen e konflikteve përmes ndërmjetësimit;
 - d) Numrit të degëve të ndërmarrjeve dhe
 - e) Anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare të punëdhënësve .

8. Institucionet e Republikës së Kosovës, në Këshillin Ekonomiko-Social, përfaqësohen nga ministrat e këtyre ministrive:
 - a) Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - b) Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave;
 - c) Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
 - d) Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
 - e) Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë.
9. Organizatat e punëtorëve (sindikatat) dhe organizatat e punëdhënësve që veprojnë dhe punojnë në Republikën e Kosovës, të cilat i plotësojnë kushtet dhe kriteret, për t'u përfaqësuar në Këshillin Ekonomiko-Social, sipas paragrafit 7, të këtij vendimi, duhet të dërgojnë shënimet dhe të dhënat për plotësimin e këtyre kriterëve në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në afatin prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij akti nënligjor.
10. Organizatat e punëmarrësve dhe punëdhënësve të cilat e fitojnë të drejtën e përfaqësimit në Këshillin Ekonomiko-Social, emrat e anëtarëve dhe zëvendësve të këtij organi duhet t'i dorëzojnë në Sekretariatit Koordinues të Këshillit Ekonomiko-Social, apo në Organin Përgjegjës të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në afatin prej 8 ditësh kur këtë e kërkon Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në formë të shkruar.
11. Të gjithë anëtarët e emëruar në Këshillin Ekonomiko-Social, duhet të kenë të emëruar zëvendësit e tyre. Të emëruar në cilësinë e zëvendësve nga institucionet e Republikës së Kosovës janë zëvendësministrat e ministrive përkatëse të përfaqësuar në Këshillin Ekonomiko-Social.
12. Përfaqësuesit e Këshillit Ekonomiko-Social do të emërohen/riemërohen në çdo tre (3) vjet.
13. Anëtarët e Këshillit Ekonomiko-Social e kanë legjitimitetin e plotë pas mbajtjes së takimit konstituiv të këtij organi, ku do të zyrtarizohet mandati i tyre.
14. Për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme nga puna, mirëqenia sociale dhe politikat ekonomike, përfaqësuesit e Këshillit Ekonomiko-Social formojnë grupe negociuese dhe të zgjedhin kryesuesin e tyre.
15. Grupi Negocues i themeluar në Këshillin Ekonomiko-Social, përbëhet prej dy (2) përfaqësuesve nga secila palë që janë anëtarë të Këshillit Ekonomiko-Social.
16. Grupi Negocues është përgjegjës për përpilimin e rekomandimeve përfundimtare për Këshillin Ekonomiko-Social, në çështjet që kanë të bëjnë me negociatat nën mandatin e tij.
17. Grupet negociatore i kryeson Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale apo përfaqësuesi i tij të cilin ai e autorizon.

18. Takimet e Këshillit Ekonomiko-Social janë të hapura dhe udhëhiqen nga Kryesuesi i Këshillit Ekonomiko-Social. Në mungesë të tij atë e zëvendëson kandidati të cilin e cakton Kryesuesi i Këshillit Ekonomiko-Social.
19. Në çështjet e diskutuara në takim, anëtarët e përhershëm të Këshillit Ekonomiko-Social, apo personat që përfaqësojnë ata, i japin qëndrimet e veta të cilën gjë mund ta bëjnë edhe me shkrim.
20. Kryesuesi apo në mungesë të tij personi që e përfaqëson atë, formulon draft vendimet për secilën çështje.
21. Vendimet e Këshillit Ekonomiko Social miratohen me marrëveshje të anëtarëve të përhershëm prezentë dhe në mungesë të tyre nga personat që përfaqësojnë ata.
22. Format e punës në këtë organ, në mënyrë të detajuar do të rregullohen dhe përcaktohen me Rregulloren për zhvillimin e punimeve të Këshillit Ekonomiko-Social.
23. Për shqyrtimin e çështjeve të përcaktuara në paragrafi 4 të këtij vendimi, Këshillin Ekonomiko-Social mban mbledhjet e veta të rregullta, së paku një herë në tre muaj.
24. Për t'i diskutuar çështjet emergjente që nuk janë në orarin e miratuar dhe që janë propozuar nga anëtarët e Këshillit Ekonomiko-Social, thirren mbledhjet e jashtëzakonshme. Takimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme thirren nga Kryesuesi i Këshillit Ekonomiko-Social.
25. Mbledhjet e Këshillit Ekonomiko-Social do të udhëhiqen nga Kryesuesi i cili do të zgjidhet sipas radhës nga përfaqësuesit e partnerëve social.
26. Kryesuesi i Këshillit Ekonomiko-Social në vitin e parë pas themelimit të këtij organi do të jetë përfaqësuesi i Qeverisë, përkatësisht Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
27. Pas përfundimit të mandatit në vitin e parë të udhëhequr nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, udhëheqja do të bëhet me rotacion nga përfaqësuesit e partnerëve social.
28. Mandati i Kryesuesit të këtij organi do të rregullohet me Rregulloren për zhvillimin e punimeve të Këshillit Ekonomiko-Social.
29. Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Këshillit Ekonomiko-Social janë:
 - a) Të drejtojë mbledhjet e Këshillit Ekonomiko-Social;
 - b) Të propozojë rendin e ditës dhe konkluzionet për takimet e Këshillit Ekonomiko Social;

- c) Të informojë Qeverinë përmes Ministrit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për rekomandimet e Këshillit Ekonomiko Social, si dhe për mendimet e organizatave të punëmarrësve dhe punëdhënësve, si dhe
- d) Detyrat tjera të përcaktuara me Rregulloren për zhvillimin e punimeve të Këshillit Ekonomiko-Social.
30. Punët profesionale, administrative dhe operative për funksionimin e drejtë dhe efikas të këtij organi, do t'i kryejë Sekretariati Koordinues i Këshillit Ekonomiko-Social, i përbërë nga përfaqësuesit e Qeverisë, organizatat e punëmarrësve dhe organizatave të punëdhënësve.
31. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ nr. 2001/17 mbi Strukturën dhe Funksionimin e Këshillit Konsultativ Trepalësh, si dhe çdo dispozitë tjetër e cila është në kundërshtim me këtë vendim.
32. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/57


Datë: 13.03.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2009, mori

V E N D I M

1. Përkrahet Projekti multietnik për komunën e Novobërdës, i cili iu ofron 29 familjeve zgjidhje të qëndrueshme nëpërmjet ndërhyrjes sociale dhe ekonomike.
2. Në përkrahje të këtij projekti ndahen mjete financiare si më poshtë:
 - a) Zyra e Kryeministrit/Zyra për Çështje të Komuniteteve 100.000 (njëqindmijë) Euro;
 - b) Ministria e Shërbimeve Publike 100.000 (njëqindmijë) Euro;
 - c) Nga Rezervat e Paparashikuara të Qeverisë 165.000 (njëqindëgjashtëdhjetë e pesëmijë) Euro;
 - d) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale 50.000 (pesëdhjetëmijë) Euro;
 - e) Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor 50.000 (pesëdhjetëmijë) Euro;
 - f) Kuvendi Komunal i Novobërdës 3.000 (tremijë) Euro;
3. Qeveria e Norvegjisë do ta përkrahë këtë projekt me 75.000 (shtatëdhjetë e pesëmijë) Euro.
4. Mjetet financiare sipas pikës 2. të këtij vendimi barten në kodin buxhetor 15 600 në Zyrën për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit, e cila është edhe bartëse e realizimit të këtij projekti.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/57
Datë: 13.03.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2009, mori


V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR. 20/48 TË DATËS 24.12.2008

1. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi Nr. 20/48 i datës 24.12.2008.
2. Pika 2. e vendimi Nr. 20/48 zëvendësohet në tërësi si në vijim:

“Hartimi i Planit të Veprimit për implementimin e kësaj strategjie, koordinimi, monitorimi dhe raportimi do të bëhet nga Zyra për Çështje të Komuniteteve në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit”.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë